



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prinjeno/Prodato Received/Delivered	12. 12. 2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/027	7927/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1353/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga:Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi –Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj –Demi-anëtarë me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.1353/2023 të datës 30.10.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organi të punësimit Komuna e Deçanit në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.1353/2023 e datës 30.10.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

(tani e tutje referuar si ankuesja), me datë 30.10.2023, me numër protokollit 6763/2023, ka parashtruar ankesë të regjistruar nën shenjen A.nr.1353/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën „ Zyrtar i të Hyrave Financiarë”, të zhvilluar nga Komuna e Deçanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Deçanit, ndërsa me datë 08.11.2023, nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit), duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është palejuar, sepse:

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës konstaton se Komuna e Deçanit, me datë 24.04.2023 ka publikuar konkursin me Nr. Reference RN000011468 për grup Specialist i Ekonomisë, për pozitën "Zyrtar i të Hyrave Financiare", ku afati për aplikim ka qenë nga data 15.05.2023 deri më datë 25.05.2023. Në këtë konkurs në bazë të listës së kandidatëve ka aplikuar dhe ankuesja, e cila fillimisht ishte përfshirë në listë të ngushtë sipas shkresës/lista e aplikantëve që janë aprovuar, ndërsa në shkresat e lëndës në lidhje me këtë konkurs ekziston një vendim i Zyrës së personelit në Komunën e Deçanit Nr.02/Zyrtarisht i datës 29.05.2023, me që rast i ishte refuzuar aplikacioni i ankueses

me arsyetimin se ankuesja nuk i plotëson kushtet për tu përfshirë në listën e ngushtë, duke i dhënë këshillën juridike që në afatin prej tre (3) ditësh të parashtror ankesë në zyrën e personelit të organit të punësimit, ndërsa nga shqyrtimi i shkresave që gjenden në lëndë, kolegji i këshillit konstaton se ankuesja nuk ka ndonjë dëshmi se i është drejtuar zyrës së personelit të organit të punësimit ashtu si ishte këshilla juridike në këtë vendim .

Ndërlidhur me këtë çështje juridike që është objekt i ankesës, përkatësisht njoftimi i datës 20.10.2023, për kandidatin fitues, Kolegji i Këshillit konstaton poashtu se ankesën në këshill ankuesja e ka parashtruar në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (e cila ishte në fuqi në kohën e shpalljes së këtij konkursi) përkatësisht nenin 25 paragrafi 5 dhe 6 të, e cila përcaktonte se: "5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrorj ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual", dhe "6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj.....", si dhe nenin 31 paragrafi 1, e cila përcaktonte se: "1. Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrorj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet", ndërsa në rastin konkret ankuesja ankesën me datën 30.10.2023, me numër protokolli 6763/2023, e ka parashtruar pa i shterur mjetet e brendshme të ankimimit në procedurat e rekrutimit ashtu siç e përcaktojnë dispozitat ligjore në fuqi të specifikuara më lartë, ndërsa kolegji i këshillit nuk u lëshue në pretendimet tjera nga se nuk ishin me relevancë për faktin se nuk ndikojnë me marrjen e ndonjë vendimi ndryshe nga ky që është marrë.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1353/2023, datë 12/12/2023

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Deçanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

